



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 173

Tiranë – E enjte, 6 gusht 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 73/2026, datë 16.7.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar..... 17581
Dekret i Presidentit nr. 456, datë 30.7.2026	Për shpallje ligji..... 17585
Ligj nr. 78/2026, datë 23.7.2026	Për statutin e shoqërisë evropiane (SE) 17585
Dekret i Presidentit nr. 465, datë 3.8.2026	Për shpallje ligji..... 17600
Ligj nr. 85/2026, datë 23.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar..... 17600
Dekret i Presidentit nr. 469, datë 4.8.2026	Për shpallje ligji..... 17603
Ligj nr. 86/2026, datë 23.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”..... 17603
Dekret i Presidentit nr. 468, datë 3.8.2026	Për shpallje ligji..... 17604
Ligj nr. 88/2026, datë 23.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar..... 17605

Dekret i Presidentit nr. 471, datë 4.8.2026	Për shpallje ligji.....	17607
Dekret i Presidentit nr. 441, datë 30.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	17607
Dekret i Presidentit nr. 442, datë 30.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	17607
Dekret i Presidentit nr. 443, datë 30.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	17608
Dekret i Presidentit nr. 444, datë 30.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	17608
Dekret i Presidentit nr. 445, datë 30.7.2026	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	17608
Dekret i Presidentit nr. 446, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17609
Dekret i Presidentit nr. 447, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17609
Dekret i Presidentit nr. 448, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17609
Dekret i Presidentit nr. 449, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17609
Dekret i Presidentit nr. 450, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17610
Dekret i Presidentit nr. 451, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17610
Dekret i Presidentit nr. 452, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17610
Dekret i Presidentit nr. 453, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17611
Dekret i Presidentit nr. 454, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17611
Dekret i Presidentit nr. 455, datë 30.7.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17611
Dekret i Presidentit nr. 464, datë 3.8.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	17612
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 14, datë 3.8.2026	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”.....	17612

Urdhër i ministrit të Bujqësisë
dhe Zhvillimit Rural nr. 766,
datë 27.7.2026

Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive,
të shfaqur në shtetin e Serbisë..... 17612

Njoftim i Ministrisë për Evropën
dhe Punët e Jashtme nr. 1953/4,
datë 3.8.2026

Për hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare..... 17613

LIGJ
Nr. 73/2026PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 9616, DATË 27.9.2006,
“PËR LIBRIN NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të shpallë veprimtari me interes publik e kombëtar prodhimin, mbrojtjen e librit dhe të produkteve të përafërta me të në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përhapjen e promovimin e tij edhe jashtë territorit të vendit.”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Objekti i këtij ligji është:

a) përcaktimi i rregullave në fushën e prodhimit, botimit, ruajtjes, mbrojtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përhapjes e promovimit të librit e të produkteve të përafërta me të jashtë territorit të vendit;

b) krijimi i kushteve për botimin e librave të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaj dhe anasjelltas;

c) aksesit i personave me aftësi të kufizuara në fushën e librit e të leximit;

ç) zhvillimi i kulturës së leximit, promovimit të librit e të autorëve;

d) promovimi i librit në formë digjitale.”.

Neni 3

Në nenin 3, “Përkufizime”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. “**Libër**” është një vepër shkencore, letrare apo e çdo lloji tjetër, që publikohet si një tërësi unitare, në një vëllim ose në vëllime të ndryshme, e shtypshkruar ose në çfarëdolloj forme tjetër të lexueshme. Përfshihen në këtë përkufizim, në zbatim të këtij ligji, librat elektronikë që publikohen në medime të tjera dhe materialet e tjera plotësuese të shtypshkruara, pamore, audio vizuale apo zanore, të cilat janë publikuar së bashku me librin dhe që përbëjnë një njësi unitare.”.

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas fjalës “për fëmijë” hiqen fjalët “dëftuesit e hekurudhave ose të rrugëve detare, repertorët, që përmbajnë vetëm të dhëna numerike, repertorët alfabetikë”;

b) Pas fjalëve “e një kënge” hiqen fjalët “fletoret e muzikës për detyra”.

3. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. “**Libër në formë elektronike**” është një botim libri, i përbërë nga tekst, imazhe ose të dyja, të lexueshme në pajisje elektronike.

4. “**Autor**” është çdo person fizik ose një grup personash fizikë, që krijon vepër letrare, artistike, shkencore, produkt intelektual origjinal, i materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit.”.

4. Në pikën 5, fjalët “106, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” zëvendësohen me fjalët “127, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.”.

5. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. “**Librashitës**” është personi fizik ose juridik, që ushtron tërësisht ose pjesërisht veprimtarinë e shitjes së librave në mjedise tregtare dhe tregje elektronike.”.

6. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“12. “**Importues**” është personi fizik ose juridik, që mundëson hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të materialeve të botuara, të shtypshkruara ose të prodhuara jashtë territorit.”.

Neni 4

Titulli i kreut III ndryshohet si më poshtë:



“Institucionet dhe organet e librit dhe leximit”.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit

1. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit (në vijim QKLL) krijohet dhe funksionon si person juridik publik, buxhetor, me statusin e institucionit qendror, në varësi të ministrisë përgjegjëse për librin.

2. Misioni i QKLL-së është ndjekja dhe zbatimi i projekteve në fushën e librit, duke synuar përhapjen e kulturës së leximit në të gjithë vendin, nxitjen e krijimtarisë, forcimin e rolit promovues dhe edukativ të bibliotekave, si dhe mbështetjen e projekteve për promovimin e letrave shqipe në tregun evropian dhe atë botëror.

3. QKLL-ja kryen detyrat si më poshtë:

a) harton programet dhe financon projektet në fushën e librit;

b) mbështet botimet e librave dhe të revistave në fushën e letërsisë e të shkencave shoqërore edhe në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara;

c) krijon kushtet nxitëse për krijuesit në fushën e letërsisë, duke siguruar mbështetje financiare dhe organizon konkurse për dhënien e çmimeve kombëtare letrare;

ç) nxit e promovon librin, autorët dhe përkthyesit shqiptarë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

d) realizon dhe promovon në forma të ndryshme:

i. bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e librit;

ii. përkthime të veprave të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaja;

iii. prezantime të letërsisë shqipe në nivel ndërkombëtar;

dh) financon programe përkthimi me prioritet përkthimin dhe botimin në gjuhë të huaja të veprave të autorëve shqiptarë, me qëllim promovimin ndërkombëtar të letërsisë shqipe. Fondet publike të destinuara për përkthimin përdoren në tërësinë e tyre për përkthimin e veprave nga gjuha shqipe në gjuhë të huaja, pa sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit;

e) krijon kushtet për zhvillimin e kulturës së leximit në të gjitha grup-moshat, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ë) promovon zhvillimin e rrjetit libror në të gjithë territorin e vendit dhe krijon kushtet për një qasje të shtuar drejt politikave të librit për lexuesit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën e Botimeve për Diasporën;

f) bashkëpunon me institucione ndërkombëtare që veprojnë në fushën e librit;

g) monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e programeve e të projekteve që mbështet;

gj) bashkëpunon me organet shtetërore për zbatimin e politikave publike dhe akteve të tjera rregulluese në fushën e librit, si dhe me organizata që kanë në fokus zhvillimin dhe përhapjen e kulturës së librit;

h) siguron fonde të jashtme dhe burime të tjera të financimit në fushën e librit sipas legjislacionit në fuqi;

i) nxjerr akte administrative dhe realizon detyra të tjera, me natyrë trajnuese e promovuese, në përputhje me qëllimin e QKLL-së;

j) i propozon ministrisë përgjegjëse për librin ndryshime në legjislacionin në fuqi në fushën e librit;

k) çdo detyrë tjetër të ngarkuar me ligj apo akt nënligjor.

4. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit nuk ushtron kompetencë licencuese, autorizuese apo klasifikuese mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari botuese. Statusi i një subjekti si shtëpi botuese, distributor ose librari përcaktohet nga regjistrimi dhe ushtrimi i veprimtarisë sipas legjislacionit tregtar dhe tatimor në fuqi.

5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të QKLL-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Këshilli Kombëtar i Librit dhe i Nxitjes së Leximit

1. Këshilli Kombëtar i Librit dhe i Nxitjes së Leximit (KKLNL) krijohet si organ këshillimor i



ministrit përgjegjës për librin për çështjet objekt të këtij ligji.

2. KKLNL-ja jep rekomandime për hartimin e politikave e të programeve për promovimin e librit, nxitjen e leximit dhe veprimtarisë botuese në vend për ruajtjen dhe mbrojtjen e traditës së librave të vjetër bukinistike, për rritjen e eksportit dhe përhapjen e librit shqip përtej kufijve shtetërorë.

3. KKLNL-ja mbështet organizimin e veprimtarive në fushën e librit, të panaireve, ekspozitave, konkurseve dhe të veprimtarive të tjera kombëtare e ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e autorëve, përkthyesve, botuesve dhe librashitësve shqiptarë e të huaj, si dhe sugjeron dhënien e çmimeve, veçanërisht për botimet e veprave me rëndësi kombëtare e në fushat që vlerësohen parësore për kulturën kombëtare.”.

Neni 7

Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.”

2. Në paragrafin e parë, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Drejtorin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.”.

3. Paragrafi i dytë riformulohet dhe numërohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Dy anëtarë, personalitete të njohura të fushës, caktohen nga ministri përgjegjës për librin për një periudhë 4-vjeçare dhe dy përfaqësues nga grupet e interesit.”.

Neni 8

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Mënyra e funksionimit të KKLNL-së

1. Mënyra e funksionimit dhe organizmit të KKLNL-së përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për politikën e librit dhe leximit.

2. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit mbështet nga ana administrative mbledhjet e KKLNL-së.”.

Neni 9

Në nenin 12 bëhen këto shtesa:

1. Pas fjalëve “kulturore e shkencore” shtohen fjalët “dhe veprave të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Procedurat, kushtet, kriteret dhe masa e bashkëfinancimit të titujve të veprave të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për librin dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale.”.

Neni 10

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

Çmimet Kombëtare të Letërsisë

1. Shteti shqiptar akordon çdo vit Çmimet Kombëtare të Letërsisë.

2. Kategoritë e çmimeve sipas pikës 1 të këtij neni propozohen nga QKLL-ja dhe miratohen nga KKLNL-ja.

3. Çmimet jepen për vepra të botuara gjatë vitit kalendarik paraardhës.

4. Juria emërohet brenda muajit janar dhe e ushtron mandatin për një vit kalendarik.

5. Juria ka në dispozicion të gjithë vitin për shqyrtimin e veprave.

6. Shpallja e fituesve bëhet jo më vonë se 20 dhjetori ose, për arsye të justifikuara, jo më vonë se 20 janari i vitit pasardhës.

7. Procedurat dhe përbërja e jurisë përcaktohen nga QKLL-ja.

8. Fondi planifikohet çdo vit në buxhetin e ministrisë përgjegjëse.”.

Neni 11

Në nenin 17 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore planifikojnë dhe përcaktojnë në buxhetet vjetore përkatëse një zë



të veçantë për blerjen e librave për bibliotekat publike të njësive të vetëqeverisjes vendore.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Fondi për librin, i miratuar në buxhetin e organit qendror apo vendor, është i patjetërsueshëm.”.

Neni 12

Në nenin 19 emërtimi “Ministritë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohet me emërtimin “Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit”.

Neni 13

Në nenin 21, pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:

“l. identifikuesi unik universal i veprës dhe i kopjes së saj gjenerohet në formën e një barkodi për çdo ekzemplar libri.

Ky identifikues përbëhet nga tre komponentë:

i. identifikuesi standard i veprës ose botimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare (ISBN dhe/ose DOI, kur aplikohet);

ii. të dhënat kohore të publikimit ose stampimit;

iii. një komponent unik i gjeneruar në mënyrë algoritmike për identifikimin individual të kopjes.

Identifikuesi unik universal nuk zëvendëson identifikuesit standardë ndërkombëtarë të veprës, si ISBN apo DOI, por i plotëson ata duke mundësuar identifikimin dhe gjurmueshmërinë e çdo kopjeje individuale në qarkullim.

Gjenerimi dhe administrimi i barkodeve unike kryhet nga Agjencia e të Drejtës së Autorit, e cila autorizohet posaçërisht për këtë funksion.”.

Neni 14

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Kontrata tip autor–botues

1. Marrëdhënia ndërmjet autorit dhe shtëpisë botuese bazohet në kontratë me shkrim.

2. Kontrata tip, e miratuar me akt nënligjor nga ministri përgjegjës, përcakton elementet minimale të detyrueshme.

3. Marrëdhënia kontraktuale realizohet në dy forma:

a) transferim i të drejtave ekonomike;

b) shpërblim proporcional për çdo kopje të shitur.

Kontrata duhet të përcaktojë afatin, territorin, formatet e botimit, tirazhin, raportimin e shitjeve dhe afatet e pagesës.

4. Çdo klauzolë që përjashton të drejtën e autorit për informim mbi shitjet është e pavlefshme.”.

Neni 15

Neni 32 shfuqizohet.

Neni 16

Në nenin 35, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kontrolli për respektimin e këtij detyrimi ushtrohet sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 17

Në nenin 42 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Fjalët “njësive administrative vendore” zëvendësohen me fjalët “njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe fjalët “në Bibliotekën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” hiqen.

2. Pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë, i dytë dhe i tretë me këtë përmbajtje:

“Biblioteka Kombëtare mban detyrimisht 3 kopje nga 5 botimet e dorëzuara dhe i shpërndan kopjet e tjera në:

a) bibliotekën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për çdo botim për titujt që i përkasin fushës së ligjit, politikave dhe qeverisjes, shkencave sociale, shkencave politike, integritetit evropian dhe titujt me tematika që mbështesin veprimtarinë parlamentare, sipas marrëveshjes së miratuar mes palëve; dhe

b) në institucionet e tjera publike në bazë të marrëveshjes së nënshkruar mes palëve dhe të miratuar nga ministri përgjegjës për librin.

Kur nga dorëzimi i kopjeve të detyruara pranë Bibliotekës Kombëtare kanë kaluar 10 vjet, përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për shpërndarjen e kopjeve mbi numrin e detyruar të



kopjeve të BKSH-së bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 18

Në nenin 48 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronjat “b” dhe “dh” shfuqizohen.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Masat administrative me gjobë jepen nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i masave administrative me gjobë bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.”.

Neni 19

Në të gjithë përmbajtjen e ligjit, emërtimet “ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “ministri përgjegjës për politikën e librit dhe leximit” dhe “ministra përgjegjëse për politikën e librit dhe leximit”.

Neni 20

Në nenin 49, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ngarkohet ministri përgjegjës për librin që brenda:

a) 12 muajve të miratojë vendimin për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të QKLL-së, në zbatim të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) 12 muajve të nxjerrë urdhrin për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të KKLNL-së, në zbatim të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

c) 12 muajve të miratojë vendimin për procedurat, kushtet, kriteret dhe masat e bashkëfinancimit të titujve të veprave të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 9616, datë

27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Neni 21

Aktet nënligjore

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të, do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në këtë ligj.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 456, datë 30.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 456, datë 30.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 73/2026, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006, ‘Për librin në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 78/2026

**PËR STATUTIN E SHOQËRISË
EVROPIANE (SE)¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

¹ Ky ligj është përafshuar plotësisht me rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2157/2001, datë 8 tetor 2001, Për statutin e shoqërisë evropiane (SE) e ndryshuar. Numri CELEX 32001R2157, Fletorja Zyrtare

e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 294, datë 10.11.2001, faqe 1–21.



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
FUSHA E ZBATIMIT, SELIA,
REGJISTRIMI DHE PUBLIKIMET

Neni 1
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj përcakton rregullat për sa u përket:
 - a) kushteve të themelimit të një shoqërie evropiane (SE) me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
 - b) funksionimit, strukturës dhe organizimit të saj të brendshëm;
 - c) marrëdhënieve me aksionarët, punëmarrësit dhe palët e treta;
 - ç) procedurave për transferimin e selisë së regjistruar të një SE-je;
 - d) procedurave për likuidimin, falimentimin ose shndërrimin e një SE-je;
 - dh) regjistrimit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet shqiptare të SE-ve që veprojnë në ose nga Shqipëria;
 - e) aspekteve të tjera që i nënshtrohen rregullimit kombëtar.

2. Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet që marrin pjesë në krijimin ose funksionimin e një shoqërie evropiane me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për autoritetet që merren me regjistrimin dhe mbikëqyrjen e saj.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, dispozitat e këtij ligji zbatohen për një shoqëri evropiane (*Societas Europea*, SE), me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe për shoqëritë me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë që marrin pjesë në themelimin e një SE-je.

Neni 2
Selia

1. SE-ja regjistrohet në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për regjistrimin e shoqërive aksionare dhe me dispozitat e këtij ligji.

2. SE-ja fiton personalitetin juridik ditën e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar të mbajtur nga

QKB-ja. Emri i shoqërisë evropiane në regjistrin tregtar të QKB-së duhet të ndiqet nga shkurtimi “SE”.

3. Statuti i SE-së duhet të përcaktojë selinë e shoqërisë, në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

4. Selia e regjistruar e SE-së duhet të përkojë me vendin ku ushtrohen funksionet kryesore të administrimit të saj (drejtimi qendror), duke përfshirë vendndodhjen e organeve ekzekutive dhe mbajtjen e dokumentacionit të shoqërisë. Nëse Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) konstaton se drejtimi qendror i një SE-je me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë është transferuar në një shtet tjetër, ajo i kërkon SE-së që brenda një afati të arsyeshëm, të përcaktuar prej saj, të rikthejë drejtimin qendror në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të nisë procedurën për transferimin e selisë së regjistruar në një shtet tjetër, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

5. Nëse SE-ja nuk rregullon situatën e selisë së saj sipas pikave të sipërpërmendura, zbatohen procedurat e parashikuara në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare për likuidimin e shoqërisë me vendim gjykate. QKB-ja njofton SE-në për konstatimin e parregullsisë dhe e publikon këtë njoftim në regjistrin tregtar.

Neni 3
Forma juridike dhe kapitali

1. Shoqëria evropiane (SE) është një shoqëri aksionare, kapitali i së cilës ndahet në aksione.

2. Kapitali i SE-së shprehet në euro. Kapitali minimal i nënshkruar nuk mund të jetë më i ulët se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) euro.

3. Përgjegjësia e çdo aksionari për detyrimet e SE-së është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.

Neni 4
Publikimi i të dhënave në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) është e detyruar të përgatisë dhe të përcjellë informacionin përkatës, në lidhje me shoqëritë evropiane (SE) të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, për qëllime publikimi në Zyrën për Botimet Zyrtare të Bashkimit Evropian. Informacioni përfshin të



dhënat standarde që zakonisht bëhen publike për SE-të në vendet anëtare të BE-së. Përcjellja e informacionit bëhet në mënyrë elektronike përmes mjeteve zyrtare të komunikimit ndërinstitucional të dakordësuara ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe institucioneve të BE-së.

KREU II TRANSFERIMI I SELISË SË REGJISTRUAR

Neni 5

Transferimi i selisë së regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian

1. Selia e regjistruar e një SE-je mund të transferohet në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian në përputhje me pikat 2 deri në 13 të këtij neni. Ky transferim nuk sjell likuidimin e SE-së dhe as krijimin e një personi juridik të ri në shtetin në të cilin selia e regjistruar transferohet.

2. Organi administrativ përgatit një propozim për transferim dhe e publikon atë sipas nenit 15 të këtij ligji.

3. Ky propozim duhet të përmbajë:

- a) emrin aktual, selinë e regjistruar dhe numrin identifikues të SE-së;
- b) selinë e propozuar të regjistruar të SE-së;
- c) statutin e propozuar të SE-së, përfshirë emrin e ri, nëse është e aplikueshme;
- ç) çdo ndikim të mundshëm të transferimit mbi përfshirjen e punonjësve;
- d) kalendarin e propozuar të transferimit;
- dh) çdo të drejtë të parashikuar për mbrojtjen e aksionarëve dhe/ose kreditorëve.

4. Organi administrativ harton një raport që shpjegon aspektet juridike dhe ekonomike të transferimit dhe pasojat që sjell për aksionarët, kreditorët dhe punëmarrësit.

5. Aksionarët dhe kreditorët e SE-së kanë të drejtë që të paktën 1 muaj para mbledhjes së përgjithshme që do të vendosë për transferimin të shqyrtojnë propozimin e raportit përkatës dhe të marrin kopje falas me kërkesë.

6. Nuk mund të merret vendim për transferim brenda 2 muajve nga data e publikimit të propozimit.

7. Përpara lëshimit të certifikatës nga QKB-ja, SE-ja duhet të provojë se për çdo detyrim të lindur para publikimit të propozimit të transferimit,

interesat e kreditorëve, aksionarëve dhe mbajtësve të të drejtave të tjera (përfshirë autoritetet publike), të parashikuara në këtë ligj, janë mbrojtur në mënyrë të përshtatshme.

8. QKB-ja lëshon certifikatën që dëshmon për përfundimin e veprimeve dhe formaliteteve para transferimit sipas këtij neni.

9. Transferimi i selisë nuk mund të realizohet pa paraqitur certifikatën e lëshuar sipas pikës 8, të këtij neni, dhe pa provuar përmbushjen e formaliteteve për regjistrim në shtetin pritës.

10. Transferimi i selisë së regjistruar dhe ndryshimi pasues i statutit marrin efekt në datën e regjistrimit të SE-së në regjistrin përkatës në shtetin e ri.

11. Pas regjistrimit të transferimit të selisë, regjistri i shtetit pritës njofton QKB-në. Fshirja nga regjistri i QKB-së bëhet pas marrjes së këtij njoftimi, por jo më herët.

12. Regjistrimi i ri dhe fshirja nga regjistri i vjetër publikohen në regjistrin tregtar të QKB-së.

13. Pas publikimit të regjistrimit të ri, selia e re mund të kundërshtohet nga palët e treta me interes të drejtpërdrejtë në transferim. Megjithatë, nëse fshirja nga regjistri i mëparshëm nuk është publikuar ende, palët e treta mund të mbështeten ende te selia e vjetër, përveç kur SE-ja provon se ato ishin në dijeni të selisë së re.

14. Në rast se SE-ja ushtron veprimtari në sektorë me rëndësi strategjike apo është subjekt i mbikëqyrjes së një autoriteti kombëtar rregullator ose financiar, ky autoritet ka të drejtë të kundërshtojë transferimin për arsye të interesit publik. Kundërshtimi i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor.

15. Një SE nuk mund të transferojë selinë e saj të regjistruar nëse ndaj saj janë hapur procedura të likuidimit dhe të falimentimit.

16. Një SE që ka transferuar selinë në një shtet anëtar do të konsiderohet për çdo shkak ligjor që ka lindur para transferimit si e regjistruar ende në Republikën e Shqipërisë, edhe nëse paditet pas transferimit.

Neni 6

Oferta e kompensimit në planin e transferimit të selisë

1. Përveç informacioneve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 5 të këtij ligji, plani për transferimin



e selisë së regjistruar të SE-së, duhet të specifikojë edhe kushtet për pagesën e kompensimit në para, për blerjen e aksioneve të ofruara një aksionari që kundërshton transferimin e selisë së regjistruar dhe e shënon këtë kundërshtim në procesverbalin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme ku merret vendimi për transferimin e selisë së regjistruar. Të njëjtën të drejtë e ka edhe një aksionar që nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sepse i është penguar në mënyrë të paligjshme pjesëmarrja ose sepse mbledhja e asamblesë së përgjithshme nuk është thirrur në mënyrë të rregullt, ose sepse çështja, objekt vendimi, nuk është njoftuar siç duhet.

2. Detyrimin për të paguar kompensimin në para mund ta marrë përsipër edhe një person tjetër.

3. Oferta për blerjen e aksioneve duhet të përcaktohet në njoftimin e planit për transferimin e selisë së regjistruar.

4. Për blerjen/nënshkrimin e aksioneve zbatohen dispozitat për nënshkrimin e aksioneve të veta nga shoqëria tregtare, në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

5. Shoqëria merr përsipër shpenzimet e transferimit të aksioneve.

Neni 7

Vlerësimi i përshtatshmërisë së kompensimit në para

1. Një ekspert i pavarur i licencuar vlerëson përshtatshmërinë e kompensimit në para, të përmendur në pikën 1, të nenit 6 të këtij ligji.

2. Eksperti i pavarur i licencuar emërohet nga këshilli mbikëqyrës ose asambleja e aksionarëve. Eksperti i pavarur i licencuar është përgjegjës ndaj SE-së dhe aksionarëve për punën e kryer prej tij.

3. Eksperti i pavarur i licencuar paraqet një raport me shkrim për vlerësimin e kryer. Raporti përmbillet me një deklaratë se kushtet e ofruara për pagesën e kompensimit në para janë ose jo të përshtatshme. Raporti duhet të përmbajë posaçërisht:

a) metodat e përdorura për të përcaktuar shumën e kompensimit në para të ofruar;

b) arsyet pse zbatimi i këtyre metodave ishte i përshtatshëm;

c) rezultatin që do të sillte zbatimi i metodave të ndryshme nëse do të ishte aplikuar më shumë se një prej tyre;

ç) peshën që i është dhënë secilës metodë dhe vështirësitë që patën gjatë vlerësimit.

4. Eksperti i pavarur i licencuar ia dorëzon raportin organit administrativ.

Neni 8

Shqyrtimi i transferimit të selisë nga këshilli mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës ose asambleja e aksionarëve të SE-së duhet të shqyrtojë transferimin e parashikuar të selisë së regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, bazuar në raportin e organit administrativ, të përmendur në pikën 4, të nenit 5 të këtij ligji, dhe të hartojë një raport me shkrim për këtë çështje. Organi administrativ nuk është i detyruar të japë informacion në raport në rast se shoqëria me vendim unanim të të gjithë aksionarëve ka vendosur që një raport i tillë i organit administrativ të mos hartohet.

Neni 9

Publikimi i planit për transferimin e selisë së regjistruar

1. Organi administrativ i SE-së duhet t'i paraqesë QKB-së planin e transferimit të selisë, të paktën 2 muaj para datës së asamblesë së përgjithshme në të cilën do të merret vendimi për transferimin e selisë së regjistruar të shoqërisë në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian dhe ta publikojë atë në faqen e internetit të shoqërisë. Plani i transferimit publikohet edhe në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Plani i publikuar duhet të përmbajë informacion për aksionarët për të drejtat e tyre, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni dhe nenit 12 të këtij ligji, si dhe kreditorët për të drejtat e tyre sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, dhe nenit 14 të këtij ligji.

2. Në selinë e regjistruar të shoqërisë, të paktën 1 muaj para datës së asamblesë së përgjithshme në të cilën merret vendimi për transferimin e selisë së regjistruar të shoqërisë, aksionarëve dhe kreditorëve të shoqërisë duhet t'u vihen në dispozicion plani i transferimit, raporti i organit administrativ, raporti i ekspertit të pavarur të licencuar, raporti i këshillit mbikëqyrës për shqyrtimin e transferimit, pasqyrat financiare vjetore më të fundit të hartuara, si dhe raporti i organit administrativ për gjendjen e shoqërisë, i cili është hartuar ose duhet të ishte hartuar.



3. Çdo aksionari dhe çdo kreditori duhet t'i jepen me kërkesën e tyre dhe me shpenzimet e shoqërisë kopje të dokumenteve të përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Dokumentet e përmendura në pikën 2 të këtij neni duhet të paraqiten në asamblenë e përgjithshme. Në fillim të diskutimit organi administrativ duhet të shpjegojë planin për transferimin e shoqërisë. Organi administrativ duhet t'i informojë aksionarët, përpara marrjes së vendimit, lidhur me të gjitha ndryshimet e rëndësishme në aktivet e shoqërisë dhe potencialin e saj ekonomik, që kanë ndodhur nga krijimi i planit për transferimin e shoqërisë deri në momentin e marrjes së vendimit në asamblenë e përgjithshme.

Neni 10

Nevoja për pëlqim të veçantë

Nëse transferimi i selisë së regjistruar të shoqërisë cenon të drejtat e dhëna me statutin e shoqërisë një aksionari të caktuar ose disa prej tyre, vendimi për transferimin e selisë së regjistruar kërkon pëlqimin e atij ose atyre aksionarëve.

Neni 11

Transferimi i thjeshtuar i selisë së regjistruar

Nëse të gjitha aksionet e shoqërisë janë në pronësi të një aksionari të vetëm ose nëse të gjithë aksionarët heqin dorë nga e drejta e tyre për kompensim në para me anë të një deklarate me shkrim ose një deklarimi të shënuar në procesverbalin e asamblesë së përgjithshme, atëherë nuk është e nevojshme që në planin e transferimit të parashikohen kushtet e ofertës së kompensimit në para dhe nuk është e nevojshme të shqyrtohet përshtatshmëria e kompensimit në para të ofruar.

Neni 12

Kompensimi në para për një aksionar që kundërshton transferimin e selisë së regjistruar

1. Çdo aksionar që deklaron kundërshtimin e tij ndaj vendimit për transferimin e selisë së regjistruar gjatë asamblesë së përgjithshme, të shënuar në procesverbal, ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë ose palës së tretë, e cila ka ofruar të paguajë kompensimin në para, që t'i paguajë atij një

kompensim të përshtatshëm në para, me kusht që ai t'ia transferojë aksionet e tij shoqërisë.

2. Deklarata për ushtrimin e kësaj të drejte mund të bëhet njëkohësisht me deklarimin e kundërshtimit në procesverbalin e asamblesë së përgjithshme ose duhet t'i paraqitet shoqërisë ose palës së tretë, që ka ofruar të paguajë kompensimin në para brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit për transferimin e selisë së regjistruar.

3. Kërkesa për pagesën e kompensimit në para kushtëzohet nga regjistrimi i ndryshimit të selisë së regjistruar në regjistrin e selisë së re dhe bëhet e pagueshme në datën e atij regjistrimi dhe skadon pas 3 vjetësh. Shoqëria ose pala e tretë duhet të mbulojë shpenzimet e transferimit të aksioneve. Personit që ka të drejtë në kompensimin në para duhet t'i ofrohet garanci se atij do t'i paguhet kompensimi në para, si dhe shpenzimet e transferimit të aksioneve.

4. Certifikata e përmendur në nenin 5 të këtij ligji mund të lëshohet vetëm pasi t'u jetë ofruar garanci e mjaftueshme aksionarëve ose pasi të jetë provuar se të gjithë aksionarët kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për një kompensim në para.

5. Deri në skadimin e afatit brenda të cilit një aksionar mund të paraqesë kërkesë për pagesën e kompensimit në para, pengesat e parashikuara në statut për të disponuar ndryshe aksionet pas marrjes së vendimit për transferimin e selisë së regjistruar nuk zbatohen ndaj atij aksionari.

Neni 13

Rishikimi gjyqësor i kompensimit në para

1. Vendimi i asamblesë së përgjithshme për transferimin e selisë së regjistruar të shoqërisë nuk mund të kontestohet me arsyetimin se oferta e kompensimit në para nuk është e përshtatshme ose se shpjegimi i ofertës së kompensimit në para në planin për transferimin e selisë së regjistruar, në raportin mbi transferimin e selisë së regjistruar, në raportin e ekspertit të pavarur të licencuar ose në raportin e këshillit mbikëqyrës mbi shqyrtimin e kryer nuk është në përputhje me ligjin.

2. Aksionarët, të cilët kanë shënuar kundërshtimin e tyre ndaj atij vendimi në procesverbalin e asamblesë së përgjithshme ku është marrë vendimi për transferimin e selisë së regjistruar, brenda 1 muaji nga data e marrjes së vendimit, mund t'i kërkojnë gjykatës në juridiksionin e së cilës ndodhet selia e regjistruar e shoqërisë të rishikojë



kompensimin në para të ofruar dhe të përcaktojë shumën e tij. Kundërshtimi i transferimit të selisë dhe shqyrtimi i tij nga gjykata bëhen në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Neni 14

Mbrojtja e kreditorëve

1. Nëse SE-ja e transferon selinë e saj në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, kreditorët e saj, jo më vonë se 1 muaj nga data e vendimit të asamblesë për transferimin e selisë së regjistruar, mund t'i kërkojnë me shkrim shoqërisë të ofrojë garanci për pretendimet e tyre, të cilat kanë lindur deri në atë moment. Kreditorët e gëzojnë këtë të drejtë vetëm nëse mund të dëshmojnë se transferimi i selisë do të vërë në rrezik shlyerjen e pretendimeve të tyre.

2. Certifikata e përmendur në pikën 7, të nenit 5 të këtij ligji, mund të lëshohet vetëm kur të gjithë kreditorëve që kanë një pretendim, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, u është dhënë garanci.

Neni 15

Regjistrimi në QKB i synimit për të transferuar selinë e regjistruar të SE-së në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian

1. Për efekt konfirmimi, sipas pikës 2, të nenit 5 të këtij ligji, të gjithë anëtarët e organit administrativ të një SE-je duhet të paraqesin në QKB një kërkesë për regjistrimin e synimit për të transferuar selinë e regjistruar të shoqërisë në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian. Kërkesës duhet t'i bashkëlidhen origjinali ose një kopje e certifikuar, e:

a) planit për transferimin e selisë së regjistruar, sipas pikës 1, të nenit 5 të këtij ligji;

b) procesverbalit të asamblesë së përgjithshme ku deklarohet vendimi për transferimin e selisë së regjistruar;

c) raportit të organit administrativ, sipas pikës 2, të nenit 5 të këtij ligji;

ç) dëshmisë së depozitimit të planit për transferimin e selisë së regjistruar në gjykatë që është publikuar me referencat përkatëse;

d) pasqyrave financiare vjetore dhe raportit për gjendjen e shoqërisë për vitin e fundit financiar ose atyre që do të duhej të ishin përgatitur për atë vit;

dh) dëshmisë se aksionarëve që kundërshtuan transferimin e selisë së regjistruar, që u është dhënë garanci për pagesën e kompensimit në para;

e) dëshmisë se u është dhënë garanci kreditorëve të shoqërisë dhe një deklaratë se, përveç kreditorëve, pretendimet e të cilëve janë plotësuar, dhe atyre për të cilët është dhënë garanci, asnjë kreditor tjetër nuk i është paraqitur shoqërisë brenda afatit të parashikuar në nenin 14 të këtij ligji.

2. Të gjithë anëtarët e organit administrativ duhet t'i paraqesin QKB-së deklaratat e mëposhtme:

a) se brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit për transferimin e selisë së regjistruar, nuk është ngritur asnjë padi për të kërkuar pavlefshmërinë e vendimit ose për ta kundërshtuar atë, ose se një padi e tillë është tërhequr, ose se të gjithë aksionarët kanë dhënë deklaratat përpara noterit publik se heqin dorë nga një padi e tillë;

b) për numrin e aksionarëve, që kanë kërkuar kompensim në para dhe deklarimi se nuk ka pengesa ligjore për transferimin e aksioneve të tyre në favor të shoqërisë ose palës që ofron kompensimin.

3. QKB-ja shqyrton nëse të gjitha veprimet juridike që duhet të kryhen përpara transferimit të selisë janë përbushur siç duhet dhe nëse është dhënë garanci për pagesën e kompensimit në para për aksionarët që dëshirojnë të tërhiqen nga shoqëria. Nëse këto kushte janë përbushur, QKB-ja bën regjistrimin dhe lëshon certifikatën sipas pikës 8, të nenit 5 të këtij ligji.

4. Gjatë regjistrimit në regjistrin tregtar të synimit për të transferuar selinë e regjistruar të shoqërisë në regjistër shënohet selia e re e planifikuar e shoqërisë, regjistri në të cilin shoqëria do të regjistrohet dhe informacioni se është lëshuar certifikata sipas nenit 5 të këtij ligji.

5. Menjëherë pas regjistrimit të synimit për transferimin e selisë së shoqërisë, selia e re e regjistruar duhet të shënohet në regjistrin e mbajtur në juridiksionin e selisë së re. Shoqëria informon QKB-në se regjistrimi është bërë, e cila pastaj *ex officio* e fshin shoqërinë nga regjistri tregtar i QKB-së.

Neni 16

Kërkesa për regjistrim nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian në Republikën e Shqipërisë

1. Të gjithë anëtarët e organit administrativ duhet të paraqesin një kërkesë për regjistrimin e



transferimit të selisë së SE-së në Republikën e Shqipërisë.

2. Me paraqitjen e kërkesës, duhet të provohet ekzistenca e SE-së. Kërkesës duhet t'i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga dispozitat e legjislacioni shqiptar për regjistrimin e shoqërive aksionare, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në origjinalin ose kopjen e noterizuar, dhe, nëse dokumentet nuk janë në gjuhën shqipe, përkthimet e tyre të certifikuara nga noteri si më poshtë:

a) statuti aktual i SE-së, i vërtetuar nga një noter publik me konfirmimin e tij se dispozitat e ndryshuara të statutit dhe vendimi për ndryshimin dhe dispozitat e pandryshuara të statutit përputhen plotësisht me tekstin e statutit bashkëlidhur kërkesës;

b) plani për transferimin e selisë së regjistruar sipas nenit 5, pika 2, të këtij ligji;

c) procesverbali i asamblesë së përgjithshme ku deklarohet vendimi për transferimin e selisë së regjistruar;

ç) dokumentet për emërimin e organit administrativ dhe zgjedhjen ose emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;

d) raporti i organit administrativ sipas nenit 5, pika 4, të këtij ligji;

dh) pasqyrat financiare vjetore dhe një raport për gjendjen e shoqërisë për vitin e fundit financiar ose ato që do të duhej të ishin përgatitur për atë vit;

e) certifikata nga organi kompetent në vendin e selisë së mëparshme të regjistruar të shoqërisë sipas nenit 5, pika 7, të këtij ligji;

ë) një ekstrakt nga regjistri i vendit të selisë së mëparshme të regjistruar të shoqërisë, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se data e lëshimit të certifikatës së përmendur në shkronjën “e”, të pikës 2 të këtij neni.

3. Të gjithë anëtarët e organit administrativ të SE-së duhet të deklarojnë para QKB-së se ndaj shoqërisë nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë për mbylljen e saj, ajo nuk është në likuidim, nuk është e paafte për të paguar borxhet ose nuk ka pezulluar përkohësisht pagesat dhe se ndaj saj nuk është duke u zhvilluar asnjë procedurë tjetër e ngjashme.

4. Pas përfundimit të regjistrimit, QKB-ja duhet të njoftojë organin kompetent që mban regjistrin në shtetin në të cilin shoqëria ishte regjistruar më parë.

KREU III

THEMELIMI I NJË SE-je NËPËRMJET BASHKIMIT TË DY OSE MË SHUMË SHOQËRIVE TREGTARE

Neni 17

Projekt marrëveshja e bashkimit dhe oferta e kompensimit në para në marrëveshjen e bashkimit

1. Organet administrative të shoqërive që do të bashkohen përgatisin një projekt marrëveshje të bashkimit, e cila përmban:

a) emrin dhe selinë e regjistruar të çdo shoqërie që bashkohet dhe atyre të propozuara për SE-në;

b) raportin e shkëmbimit të aksioneve dhe kompensimet përkatëse;

c) termat dhe mënyrat e shpërndarjes së aksioneve në SE për aksionarët e shoqërive pjesëmarrëse në bashkim, përfshirë formën, klasën, të drejtat që rrjedhin prej tyre dhe datën e dhënies së tyre;

ç) datën nga e cila aksionarët e SE-së kanë të drejtë për pjesëmarrje në fitim dhe çdo kusht të veçantë që lidhet me këtë të drejtë;

d) datën nga e cila transaksionet kontabël të shoqërive që bashkohen do të konsiderohen si të SE-së;

dh) të drejtat që SE-ja u njeh mbajtësve të aksioneve me të drejta të veçanta dhe mbajtësve të instrumenteve të tjera financiare;

e) përfitimet e veçanta të dhëna ekspertëve apo anëtarëve të organeve të shoqërive që bashkohen;

ë) statutin e propozuar të SE-së;

f) informacion për procedurat për përfshirjen e punëmarrësve.

2. Përveç informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, projekt marrëveshja e bashkimit duhet të përmbajë edhe kushtet për pagesën e kompensimit në para ndaj një aksionari që kundërshton transferimin e aktiveve të shoqërisë në një SE, me seli të regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, kompensim ky që i ofrohet nga shoqëria ose një palë e tretë për transferimin e aksioneve.

Neni 18

Shqyrtimi i bashkimit

1. Marrëveshja e bashkimit duhet të shqyrtohet nga një ose më shumë ekspertë të pavarur të



licencuar për secilën shoqëri që merr pjesë në bashkim. Dispozitat e zbatueshme për bashkimin ndërkufitar të shoqërive, sipas ligjit shqiptar për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare, zbatohen edhe në rastin e bashkimit të SE-ve.

2. Si pjesë e këtij shqyrtimi, duhet të ekzaminohet, gjithashtu, përshtatshmëria e kushteve për pagesën e kompensimit në para ndaj një aksionari që kundërshton transferimin e aktiveve të shoqërisë në një SE me seli të regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, kompensim ky që i ofrohet për transferimin e aksioneve nga shoqëria ose një palë e tretë.

Neni 19

Publikimi i marrëveshjes së bashkimit

1. Shoqëria duhet të dorëzojë marrëveshjen e bashkimit ose propozimin e saj në QKB dhe ta publikojë atë në mënyrën e përcaktuar në rastet e bashkimit ndërkufitar të shoqërive, sipas ligjit shqiptar për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare. Njoftimi se marrëveshja e bashkimit ose propozimi i saj është dorëzuar në QKB duhet të përmbajë informacionin e përmendur në pikën 3 të këtij neni dhe t'i informojë aksionarët për të drejtat e tyre, sipas nenit 21 të këtij ligji dhe kreditorët për të drejtat e tyre sipas pikës 2, të këtij neni dhe nenit 22 të këtij ligji.

2. Me kërkesë të çdo kreditori të një shoqërie, aktivet e së cilës transferohen në një SE me seli të regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, dokumentet që u janë vendosur në dispozicion aksionarëve, duhet t'i vihen atij në dispozicion pa vonesë dhe me shpenzimet e shoqërisë.

3. Për secilën nga shoqëritë që marrin pjesë në bashkim për qëllime të krijimit të një SE-je, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj publikohet projekti i bashkimit në faqen zyrtare të internetit të QKB-së. Publikimi i projektit të bashkimit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm për:

a) formën ligjore, emrin dhe selinë të secilës shoqëri që bashkohet;

b) regjistrin tregtar në të cilin janë depozituar dokumentet e secilës shoqëri, si dhe numrin e regjistrimit në regjistr;

c) informacionin për procedurat që u mundësojnë kreditorëve të ushtrojnë të drejtat e

tyre, si dhe adresën ku këto informacione mund të merren falas;

ç) informacionin për procedurat që u mundësojnë aksionarëve të pakicës të ushtrojnë të drejtat e tyre në të njëjtën mënyrë në të cilën ato ushtrohen për shoqëritë aksionare, sipas ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe adresën ku mund të drejtohen;

d) emrin e propozuar dhe selinë e propozuar të shoqërisë evropiane (SE).

Neni 20

Bashkim i thjeshtuar

Nëse të gjitha aksionet e shoqërisë zotërohen nga një aksionar i vetëm ose nëse të gjithë aksionarët heqin dorë nga e drejta e tyre për kompensim në para me një deklaratë me shkrim ose një deklaram të shënuar në procesverbalin e asamblesë së përgjithshme, atëherë nuk është e nevojshme që në marrëveshjen e bashkimit të përcaktohen kushtet e ofrimit të kompensimit në para dhe nuk është e nevojshme të shqyrtohet përshtatshmëria e tij.

Neni 21

Kompensimi në para për një aksionar që kundërshton bashkimin e shoqërive

Çdo aksionar i një shoqërie, aktivet e së cilës transferohen në një SE me seli në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, i cili në asamblenë e përgjithshme deklaron në procesverbal kundërshtimin e tij ndaj vendimit për bashkimin e shoqërive, ka të drejtë të kërkojë nga shoqëria ose nga një person i tretë, që ka ofruar të paguajë kompensimin në para, që t'i paguhet një kompensim i përshtatshëm në para dhe që ai t'ia transferojë aksionet e tij atij. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e neneve 12 dhe 13 të këtij ligji.

Neni 22

Mbrojtja e kreditorëve dhe e mbajtësve të të drejtave të veçanta

1. Nëse një shoqëri transferon aktivet e saj në një SE me seli të regjistruar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, zbatohen, sipas rastit, dispozitat e nenit 14 të këtij ligji. Certifikata e parabashkimit, e lëshuar nga noteri në rastin e bashkimit ndërkufitar të shoqërive tregtare, sipas



ligjit shqiptar për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare, mund të lëshohet vetëm pasi të jetë konstatuar se mbajtësve të aksioneve me të drejta të veçanta dhe mbajtësve të instrumenteve të tjera financiare u janë dhënë të njëjtat të drejta.

2. Kërkesa për regjistrim në regjistrin e QKB-së të bashkimit të synuar, që përfshin transferimin e aktiveve të një shoqërie me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë në një SE me seli të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të BE-së, mund të paraqitet vetëm pasi të jenë përmbushur kërkesat e këtij neni për mbrojtjen e kreditorëve dhe të mbajtësve të të drejtave të veçanta.

Neni 23

Regjistrimi i bashkimit dhe lëshimi i certifikatës së parabashkimit

1. Të gjithë anëtarët e organit administrativ të një shoqërie që transferon aktivet në një SE me seli në një shtet anëtar të BE-së duhet t'i paraqesin QKB-së për regjistrim në regjistrin tregtar bashkimit e synuar. Kërkesës duhet t'i bashkëlidhen origjinali ose një kopje e vërtetuar ose një kopje e:

a) marrëveshjes së nënshkruar të bashkimit ose projektit të asaj marrëveshjeje të miratuar nga asambleja;

b) procesverbalit të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë që transferon aktivet, ku deklarohet vendimi për bashkim;

c) nëse bashkimi kërkon ndonjë miratim nga një organ shtetëror, të miratimit të atij organi;

ç) raportit të bashkimit të përgatitur nga organi administrativ i shoqërisë;

d) raportit të ekspertit të pavarur të licencuar për bashkimin;

dh) pasqyrave financiare përfundimtare të shoqërisë që transferon aktivet;

e) dëshmisë se depozitimi i marrëveshjes së bashkimit ose i projektit të saj, i depozituar në QKB sipas këtij neni, është publikuar edhe në faqen e internetit të shoqërisë që transferon aktivet;

ë) dëshmisë se është dhënë garanci për pagesën e kompensimit të përshtatshëm në para aksionarëve që kundërshtojnë bashkimin;

f) dëshmisë se u është dhënë garanci kreditorëve dhe një deklaratë se, përveç kreditorëve të shlyer dhe kreditorëve ndaj të cilëve është dhënë garanci, nuk

ka kreditorë të tjerë që i janë paraqitur shoqërisë brenda afatit të parashikuar.

2. Të gjithë anëtarët e organit administrativ duhet t'i paraqesin QKB-së deklaratat se brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit për bashkimin e shoqërive nuk është ngritur asnjë padi për të kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit ose për ta kundërshtuar atë, ose se një padi e tillë është tërhequr, ose se të gjithë aksionarët kanë dhënë deklaratë përpara noterit publik se heqin dorë nga një padi e tillë, si dhe nëse dhe sa aksionarë kanë ushtruar të drejtën për të marrë një kompensim në para dhe se aksionet e aksionarëve, që kundërshtuan bashkimin e shoqërive, mund të merren sipas ligjit.

3. QKB-ja është e detyruar të shqyrtojë nëse të gjitha veprimet juridike dhe formalitetet që duhet të kryhen përpara bashkimit të shoqërive, sipas këtij ligji, janë kryer siç duhet dhe nëse u është dhënë garanci kreditorëve për pretendimet e tyre ndaj shoqërisë, mbajtësve të të drejtave të veçanta dhe aksionarëve, që kundërshtuan bashkimin, për pagesën e kompensimit në para për aksionarët që dëshirojnë të tërhiqen nga shoqëria. Nëse këto kushte janë përmbushur, QKB-ja bën regjistrimin dhe lëshon një certifikatë parabashkimi, e cila kërkohej edhe në kuptim të nenit 22, pika 2, të këtij ligji.

4. Gjatë regjistrimit të bashkimit të synuar në regjistrin e tregtar të QKB-së duhet të shënohet selia e planifikuar e regjistruar e SE-së, regjistri në të cilin shoqëria do të regjistrohet dhe fakti që është lëshuar certifikata e parabashkimit sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Menjëherë pas regjistrimit të bashkimit e synuar të shoqërive në regjistrin e ri, organi administrativ duhet të paraqesë një kërkesë për regjistrimin e bashkimit dhe për fshirjen e shoqërisë nga regjistri tregtar i QKB-së së bashku me njoftimin nga regjistri i selisë së re të regjistruar të shoqërisë. Nëse njoftimi nuk është në gjuhën shqipe, ai duhet të paraqitet në një përkthim të certifikuar në gjuhën shqipe.

Neni 24

Marrëveshja për pjesëmarrjen e punëmarrësve si kusht për regjistrimin

1. Çdo shoqëri pjesëmarrëse në bashkim ka të drejtë të kushtëzojë pjesëmarrjen e saj në SE me miratimin e mënyrës së pjesëmarrjes së punëmarrësve, në përputhje me dispozitat për



pjesëmarrjen e punëmarrësve të parashikuara në këtë ligj.

2. Në rast se marrëveshja për pjesëmarrjen e punëmarrësve nuk është arritur brenda afatit të përcaktuar me ligj, asnjë shoqëri pjesëmarrëse nuk mund të detyrohet të marrë pjesë në shoqërinë evropiane.

3. Certifikata e parabashkimit, e parashikuar në nenin 23 të këtij ligji, nuk mund të lëshohet në mungesë të dokumentacionit që vërteton se çështjet e përfaqësimit të punëmarrësve janë zgjidhur në përputhje me këtë ligj, kur pjesëmarrja e punëmarrësve, sipas pikës 1 të këtij neni, ishte vendosur si kusht nga ndonjë prej shoqërive pjesëmarrëse.

Neni 25

Themelimi i një shoqërie evropiane mbajtëse (*holding*)

1. Një SE mund të krijohet edhe me themelimin e një SE-je mbajtëse nga dy ose më shumë shoqëri tregtare, që u nënshtrohen legjislacioneve të ndryshme me kusht që të paktën dy prej tyre të kenë pasur për të paktën dy vjet një shoqëri filiale të rregulluar nga ligji i një shteti tjetër anëtar ose një degë të vendosur në një shtet tjetër anëtar.

2. Aksionarët e shoqërive pjesëmarrëse kanë një afat tremujor për të njoftuar nëse do të kontribuojnë aksionet e tyre për krijimin e SE-së mbajtëse. Ky afat fillon nga data kur kushtet përfundimtare për themelimin e SE-së mbajtëse, të përcaktuara në përputhje me nenet 26 dhe 27 të këtij ligji, janë zbatuar.

3. Kur kushtet sipas nenit 27 të këtij ligji janë përmbushur për secilën shoqëri pjesëmarrëse, projekti i themelimit të SE-së mbajtëse publikohet në regjistrin tregtar përkatës, si dhe në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja, në përputhje me kërkesat për regjistrimet e detyrueshme të ligjit shqiptar për regjistrimin e biznesit të paktën 1 muaj para datës së mbledhjes së përgjithshme, që do të vendosë për miratimin e tij.

4. Aksionarët që nuk kanë shprehur qëndrimin e tyre gjatë afatit të parë, kanë një afat shtesë njëmuajor për të njoftuar vendimin e tyre.

5. SE-ja mbajtëse nuk mund të regjistrohet pa u konfirmuar se janë përmbushur të gjitha formalitetet sipas nenit 27 të këtij ligji dhe afateve të parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

6. SE-ja mbajtëse themelohet vetëm nëse brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 apo afatit shtesë të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, aksionarët kontribuojnë përqindjen minimale të aksioneve në secilën shoqëri në përputhje me projektin dhe përmbushen të gjitha kushtet e tjera.

7. Teksti i statutit, i miratuar përpara një noteri publik, duhet të jetë identik me tekstin e statutit të përfshirë në projekt marrëveshjen e bashkimit. Për qëllime të përcaktimit të kapitalit aksionar, mjafton që në projekt marrëveshjen e bashkimit të përcaktohet shuma minimale e kapitalit të kërkuar për themelimin e SE-së dhe shuma maksimale që mund të arrihet me kontributin e aksionarëve.

Neni 26

Zbatimi i dispozitave për bashkimet e shoqërive

Dispozitat e zbatueshme për bashkimin me krijimin e një shoqërie të re, sipas ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, zbatohen edhe në rastin e krijimit të një SE-je mbajtëse (*holding*), sipas këtij ligji.

Neni 27

Procedura për krijimin e një SE-je mbajtëse

1. Shoqëritë tregtare që përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji mund të marrin nismën për themelimin e shoqërisë evropiane mbajtëse. Shoqëritë që marrin nismën për themelimin e SE-së mbajtëse vazhdojnë të ekzistojnë pas themelimit të SE-së mbajtëse.

2. Organet administrative të shoqërive pjesëmarrëse hartojnë një projekt të përbashkët për themelimin e SE-së mbajtëse, i cili përfshin:

a) një raport shpjegues për aspektet juridike dhe ekonomike të themelimit, si dhe pasojat për aksionarët e punonjësit nga adoptimi i formës së SE-së mbajtëse;

b) të dhënat e parashikuara në nenin 17 të këtij ligji;

c) përqindjen minimale të aksioneve në secilën shoqëri pjesëmarrëse që duhet të kontribuohen për krijimin e SE-së mbajtëse. Kjo përqindje duhet të përbëhet nga aksione që japin më shumë se 50% të të drejtave të përhershme të votimit;

ç) deklaraten se brenda 1 muaji nga data e vendimit për themelimin, sipas pikës 1 të këtij neni,



nuk është ngritur asnjë padi për të kërkuar shpalljen e vendimit të pavlefshëm ose për ta kundërshtuar atë, ose se një padi e tillë është tërhequr, ose se të gjithë aksionarët kanë dhënë deklarata përpara një noteri publik se heqin dorë nga një padi e tillë;

d) informacionin nëse dhe sa aksionarë kanë ushtruar të drejtën e tyre për të marrë një kompensim në para dhe se aksionet e aksionarëve që kundërshtuan bashkimin e shoqërive mund të merren sipas ligjit.

3. Për secilën shoqëri pjesëmarrëse, projekti i themelimit të SE-së mbajtëse publikohet në regjistrin tregtar përkatës, si dhe në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja, në përputhje me kërkesat për regjistrimet e detyrueshme sipas ligjit shqiptar për regjistrimin e biznesit, të paktën 1 muaj para datës së mbledhjes së përgjithshme që do të vendosë për miratimin e tij.

4. Një ose më shumë ekspertë të pavarur nga shoqëritë pjesëmarrëse e shqyrtojnë projektin e hartuar sipas pikës 2 të këtij neni dhe hartojnë një raport me shkrim për aksionarët e secilës shoqëri.

5. Raporti i ekspertit duhet të paraqesë çdo vështirësi të veçantë të vlerësimit dhe të analizojë nëse raporti i këmbimit të aksioneve është i drejtë dhe i arsyeshëm, duke përshkruar metodat e përdorura dhe përshtatshmërinë e tyre.

6. Mbledhja e përgjithshme e secilës shoqëri miraton projektin për themelimin e SE-së mbajtëse. Pjesëmarrja e punëmarrësve në SE përcaktohet në përputhje me nenet 3 dhe 24 të këtij ligji.

Neni 28

Miratimi nga QKB-ja i regjistrimit të një SE-je mbajtëse

QKB-ja është e detyruar të shqyrtojë nëse aksionarët në shoqëritë që synojnë të themelojnë një SE mbajtëse kanë paguar përqindjen minimale të aksioneve të përcaktuar për secilën shoqëri, në përputhje me planin e themelimit, brenda afatit të parashikuar, nëse të gjitha kushtet e tjera janë plotësuar dhe të gjitha veprimet juridike janë ndërmarrë dhe të gjitha formalitetet për themelimin e një SE-je mbajtëse janë përbushur siç duhet. Nëse kjo është bërë, QKB-ja bën regjistrimin në regjistrin e saj tregtar dhe lëshon një certifikatë që të gjitha veprimet juridike janë kryer siç duhet dhe të gjitha formalitetet e kërkuara për themelimin e një SE-je mbajtëse janë përbushur siç duhet.

Neni 29

Plani i shndërrimit

1. Plani i shndërrimit duhet të përmbajë të paktën:

a) të dhënat e shoqërisë ekzistuese, selinë e regjistruar dhe numrin e regjistrimit të shoqërisë që po shndërrohet;

b) statutin e propozuar për SE-në dhe për shoqërinë e re;

c) pasojat e mundshme të shndërrimit në pjesëmarrjen e punëmarrësve;

ç) afatin kohor të parashikuar për shndërrimin;

d) mbrojtjen e mundshme të të drejtave të parashikueshme të aksionarëve dhe/ose kreditorëve.

2. Organi administrativ i shoqërisë harton një raport të detajuar, që shpjegon bazën ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar, përshkruan vështirësitë e veçanta të vlerësimit të hasura dhe efektin që do të ketë shndërrimi të punëmarrësit.

Neni 30

Shqyrtimi i shndërrimit

1. Përpara mbledhjes së përgjithshme ku merret vendimi për miratimin e shndërrimit të një shoqërie në shoqëri evropiane (SE), një ose më shumë ekspertë të pavarur të licencuar duhet të vërtetojnë me raport të arsyetuar se vlera neto e aktiveve të shoqërisë nuk është më e vogël se shumica e kapitalit të saj themeltar dhe e rezervave, të cilat, sipas dispozitave ligjore ose statutit të shoqërisë, nuk mund të shpërndahen.

2. Vlerësimi dhe raporti i ekspertëve bëhen në përputhje me parimet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar për kontributet në natyrë dhe vlerësimin e pasurive në kuadër të themelimit dhe rritjes së kapitalit të shoqërive aksionare.

3. Përfaqësuesit e organit administrativ apo mbikëqyrës të shoqërisë që shndërrohet mbajnë përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar nga shkelja e detyrimeve të tyre gjatë procesit të shndërrimit, në përputhje me legjislacionin shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 31

Publikimi i planit të shndërrimit

1. Organi administrativ i shoqërisë duhet të paraqesë planin e shndërrimit në QKB, të paktën 1



muaj para datës së mbledhjes së përgjithshme, ku merret vendimi për miratimin e shndërrimit, dhe të shpallë në faqen e internetit të shoqërisë se ky veprim është kryer. Njoftimi duhet t'i informojë aksionarët për të drejtat e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Plani i shndërrimit, raporti i organit administrativ mbi shndërrimin, raporti i ekspertit mbi shndërrimin si dhe pasqyrat financiare vjetore dhe raporti për gjendjen e shoqërisë, të përgatitura së fundi ose që duhej të përgatiteshin sipas ligjit, duhet të jenë të disponueshme për shqyrtim nga aksionarët në ambientet e shoqërisë në selinë e saj të regjistruar të paktën 1 muaj para datës së mbledhjes së përgjithshme, të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Me kërkesën e tyre, çdo aksionari duhet t'i vihen në dispozicion me shpenzimet e shoqërisë kopje të dokumenteve të përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Dokumentet e përmendura në pikën 2 të këtij neni duhet të jenë të disponueshme edhe gjatë mbledhjes së përgjithshme. Para fillimit të diskutimeve, organi administrativ duhet të japë një shpjegim verbal për planin e shndërrimit dhe duhet të informojë aksionarët para marrjes së vendimit për çdo ndryshim të rëndësishëm në aktivet e shoqërisë dhe kapacitetin e saj ekonomik që ka ndodhur midis hartimit të planit të shndërrimit dhe momentit të vendimmarrjes në asamblenë e përgjithshme.

Neni 32

Aplikimi për regjistrimin e shndërrimit në QKB

Organi administrativ është i detyruar të paraqesë një aplikim në QKB për qëllime regjistrimi të shndërrimit. Aplikimit i bashkëlidhen në origjinal ose në kopje të noterizuar dokumentet e mëposhtme:

- a) plani i shndërrimit;
- b) procesverbali i mbledhjes së përgjithshme që përmban vendimin për shndërrimin;
- c) nëse shndërrimi kërkon miratim nga një organ shtetëror, atë miratim;
- ç) raporti i bordit drejtues për shndërrimin;
- d) provë për publikimin e dorëzimit të planit të shndërrimit në QKB, përveçse kur të gjithë aksionarët morën pjesë ose u përfaqësuan në

mbledhjen e përgjithshme dhe nuk shprehën kundërshtim ndaj vendimit të marrë;

dh) raporti i ekspertit të pavarur për shndërrimin;

e) pasqyrat financiare vjetore dhe raporti për gjendjen e shoqërisë, të përgatitura së fundi ose që duhet të ishin përgatitur.

Neni 33

Shndërrimi i një SE-je në shoqëri aksionare

Dispozitat e neneve 29 deri 32 të këtij ligji zbatohen në mënyrë të përshtatshme për shndërrimin e një SE-je në një shoqëri aksionare.

KREU IV

STRUKTURA E SE-ve

Neni 34

Organet e SE-së

1. Organet e SE-së janë asambleja e përgjithshme e aksionarëve dhe:

a) këshilli i administrimit në sistemin me një nivel drejtimi;

b) këshilli mbikëqyrës dhe administratori/ët në sistemin me dy nivele drejtimi.

2. Për qëllimet e këtij ligji, kudo ku përdoret termi “organ administrativ” nënkupton këshillin e administrimit (për sistemin me një nivel) ose administratorin/ët (për sistemin me dy nivele).

Neni 35

Organizimi i organit drejtues

1. Organi administrativ është përgjegjës për përfaqësimin ligjor dhe drejtimin e veprimtarisë së SE-së. Përfaqësimi ligjor mund të kryhet nga një ose më shumë administratorë.

2. Për sa i takon mënyrës së organizimit, mbledhjes, kompetencave, të drejtave e detyrimeve të organit administrativ, zbatohen dispozitat përkatëse për shoqëritë aksionare sipas ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

3. Anëtarë ose anëtarët e organit administrativ emërohen dhe shkarkohen nga këshilli mbikëqyrës. Megjithatë, statuti i SE-së mund të parashikojë që emërimi dhe shkarkimi të bëhet nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve sipas të njëjtave rregulla që zbatohen për shoqëritë aksionare të regjistruara në Shqipëri.



4. Askush nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i organit administrativ dhe i këshillit mbikëqyrës të së njëjtës SE. Këshillit mbikëqyrës, megjithatë, i lejohej të emërojë një nga anëtarët e tij për të vepruar si anëtar i përkohshëm i organit drejtues në rast vakance. Gjatë kësaj periudhe, funksionet e tij si anëtar i këshillit mbikëqyrës pezullohen.

5. Numri i anëtarëve të organit administrativ ose rregullat për përcaktimin e tij vendosen në statutin e SE-së.

Neni 36

Organizimi i këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës mbikëqyr veprimtarinë e organit administrativ. Ai nuk mund t'i ushtrojë vetë kompetencat e drejtimit të SE-së.

2. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës emërohen nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, për sa i takon mënyrës së organizimit, kompetencave, vendimmarrjes, të drejtave e detyrimeve të këshillit mbikëqyrës, zbatohen dispozitat përkatëse për shoqëritë aksionare sipas ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

4. Numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës ose rregullat për caktimin e tyre vendosen në statutin e SE-së.

Neni 37

Informimi dhe mbikëqyrja

1. Organi administrativ i paraqet këshillit mbikëqyrës të paktën çdo 3 muaj një raport për ecurinë dhe zhvillimet e parashikueshme të veprimtarisë së SE-së.

2. Përveç informacioneve të rregullta, organi administrativ duhet t'i përcjellë menjëherë këshillit mbikëqyrës çdo informacion për ngjarje që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në SE.

3. Këshilli mbikëqyrës mund të kërkojë nga organi administrativ çdo lloj informacioni të nevojshëm për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës, sipas pikës 1, të nenit 36 të këtij ligji.

4. Këshilli mbikëqyrës mund të ndërmarrë ose të porosisë çdo hetim që e konsideron të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

5. Çdo anëtar i këshillit mbikëqyrës ka të drejtë të shqyrtojë të gjitha informacionet që i janë paraqitur atij organi.

Neni 38

Kryetari i këshillit mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës zgjedh një kryetar nga radhët e anëtarëve të tij. Nëse gjysma e anëtarëve janë emëruar nga punëmarrësit, vetëm një anëtar i emëruar nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve mund të zgjidhet kryetar.

Neni 39

Organizimi i organit administrativ

1. Organi administrativ është përgjegjës për përfaqësimin ligjor dhe drejtimin e veprimtarisë së SE-së. Përfaqësimi ligjor mund të kryhet nga një ose më shumë administratorë.

2. Përveçse ku parashikohet ndryshe në këtë ligj, për sa i takon mbledhjes, mënyrës së organizimit, pjesëmarrjes, përfaqësimit, kompetencave, vendimmarrjes, të drejtave e detyrimeve të organit administrativ, zbatohen dispozitat përkatëse për shoqëritë aksionare sipas ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

3. Numri i anëtarëve të organit administrativ ose rregullat për përcaktimin e tij vendosen në statutin e SE-së, por në çdo rast duhet të përbëhet nga të paktën tre anëtarë.

4. Anëtari ose anëtarët e organit administrativ emërohen nga mbledhja e përgjithshme.

Neni 40

Mbledhjet e organit administrativ

1. Organi administrativ mbledhet të paktën një herë çdo tre muaj në përputhje me afatet e përcaktuara në statut për të shqyrtuar ecurinë dhe zhvillimet e parashikueshme të veprimtarisë së SE-së.

2. Çdo anëtar i organit administrativ ka të drejtë të shqyrtojë të gjithë informacionin që i paraqitet këtij organi.

Neni 41

Kryetari i organit administrativ

Organi administrativ zgjedh një kryetar nga radhët e anëtarëve të tij. Nëse gjysma e anëtarëve janë emëruar nga punëmarrësit, vetëm një anëtar i emëruar nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve mund të zgjidhet kryetar.



Neni 42

Mandati i anëtarëve të organeve të SE-së

1. Anëtarët e organeve të SE-së emërohen për një periudhë të përcaktuar në statut, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 6 vjet.

2. Me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në statut, anëtarët mund të rrimërohen një ose më shumë herë për periudha në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 43

Kushtet për anëtarësim në organet e SE-së

1. Një person nuk mund të jetë anëtar i ndonjë organi të SE-së apo përfaqësues i një anëtari nëse:

a) është i përjashtuar nga e drejta për të qenë anëtar i organit përkatës të një shoqërie aksionare sipas ligjit të shtetit anëtar të Bashkimit Evropian ku SE-ja ka selinë; ose

b) është i përjashtuar nga kjo e drejtë me vendim gjyqësor apo administrativ në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian.

2. Ky ligj nuk cenon të drejtën e parashikuar në ligjin shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare për emërimin e disa anëtarëve të organeve nga aksionarët e pakicës ose nga persona apo autoritete të tjera, nëse ka të tilla.

Neni 44

Transaksione që kërkojnë autorizim

1. Statuti i SE-së duhet të përmbajë listën dhe karakteristikat e atyre transaksioneve që do të kërkojnë:

a) autorizimin e këshillit mbikëqyrës (në sistemin me dy nivele); ose

b) një vendim të posaçëm të asamblesë së aksionarëve (në sistemin me një nivel).

2. Kategoritë e transaksioneve, që kërkojnë miratim dhe që duhet të përfshihen minimalisht në statutin e SE-së, janë ato që parashikohen, sipas rastit, për shoqëritë aksionare në ligjin shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Statuti i SE-së mund të parashikojë një gamë më të gjerë transaksionesh që kërkojnë miratim.

Neni 45

Konfidencialiteti i informacionit

Anëtarët e organeve të SE-së janë të detyruar edhe pas përfundimit të mandatit të tyre të mos bëjnë publik asnjë informacion për SE-në, i cili, nëse

zbulohet, mund të dëmtojë interesat e shoqërisë, përveç rasteve kur publikimi kërkohet ose lejohet nga ligji i zbatueshëm për shoqëritë aksionare ose kur kjo kërkohet nga organet që kanë të drejtë ligjore për ta kërkuar këtë.

Neni 46

Përgjegjësia e anëtarëve të organeve

Aksionarët, anëtarët e organeve mbikëqyrëse dhe administrative të një SE-je janë përgjegjës në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare për çdo dëm të shkaktuar ndaj SE-së, si rezultat i shkeljes së detyrimeve ligjore, statutore ose të tjera që rrjedhin nga funksioni i tyre.

Neni 47

Kompetencat e mbledhjes së përgjithshme

Mbledhja e përgjithshme vendos për çështjet për të cilat ka kompetencë sipas këtij ligji ose sipas ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, për sa i takon mënyrës së organizimit, mbledhjes, pjesëmarrjes, përfaqësimit, kompetencave, vendim-marrjes, të drejtave e detyrimeve të asamblesë së aksionarëve dhe secilit aksionar, zbatohen dispozitat përkatëse për shoqëritë aksionare të ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 48

Mbledhja e përgjithshme vjetore dhe të tjera

1. SE-ja mban një mbledhje të përgjithshme të paktën një herë në vit brenda gjashtë muajve nga përfundimi i vitit financiar.

2. Mbledhjet e përgjithshme mund të thirren në çdo kohë nga organi drejtues, organi administrativ, organi mbikëqyrës ose çdo organ tjetër apo autoritet kompetent, sipas legjislacionit kombëtar për shoqëritë aksionare në shtetin anëtar përkatës.

**KREU V
PUNËMARRËSIT**

Neni 49

Pjesëmarrja e punëmarrësve

1. Pjesëmarrja e punëmarrësve në një shoqëri evropiane (SE), me seli të regjistruar në Republikën



e Shqipërisë, rregullohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi që garantojnë të drejtën për informim, konsultim dhe, kur parashikohet, përfaqësim në organet vendim-marrëse të shoqërisë.

2. Rregullat për pjesëmarrjen e punëmarrësve në SE zbatohen në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtat kushte si për shoqëritë aksionare të krijuara sipas legjislacionit shqiptar, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.

3. Në rastet kur krijimi i një SE-je përfshin një ose më shumë shoqëri nga juridiksione të ndryshme, përfshirë juridiksione të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, pjesëmarrja e punëmarrësve përcaktohet nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet palëve, që respekton parimin e ruajtjes së të drejtave të përfaqësimit ekzistuese në shoqëritë pjesëmarrëse.

4. Marrëveshja sipas pikës 3 të këtij neni hartohet nga një grup i posaçëm negociues, i cili përbëhet nga përfaqësues të punëmarrësve të shoqërive pjesëmarrëse dhe miratohet nga organet kompetente të SE-së, në përputhje me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore.

5. Nëse nuk arrihet marrëveshje për pjesëmarrjen e punëmarrësve brenda afatit të përcaktuar me ligj, zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar për përfaqësimin dhe konsultimin kolektiv të punonjësve në shoqëritë tregtare.

6. QKB-ja nuk mund të regjistrojë një SE nëse nuk provohet se janë zbatuar dispozitat e këtij neni dhe, sipas rastit, është lidhur një marrëveshje për pjesëmarrjen e punëmarrësve ose është dokumentuar pamundësia për arritjen e saj brenda afateve të përcaktuara me ligj.

KREU VI

PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE PASQYRAT E KONSOLIDUARA

Neni 50

Zbatimi i rregullave kombëtare për pasqyrat financiare

Një SE u nënshtrohet rregullave që zbatohen për shoqëritë aksionare sipas legjislacionit përkatës për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe legjislacionit përkatës për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 51

Dispozita të veçanta për institucionet financiare dhe të sigurimit

Një SE që është institucion i mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë dhe/ose nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u nënshtrohet rregullave të përcaktuara në legjislacionin e posaçëm, që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre, për sa i përket:

- a) hartimit të pasqyrave financiare vjetore dhe, kur është e nevojshme, të pasqyrave të konsoliduara;
- b) raportit vjetor shoqërues;
- c) auditimit;
- ç) publikimit dhe dorëzimit të pasqyrave financiare.

KREU VII

PRISHJA, LIKUIDIMI, FALIMENTIMI DHE PEZULLIMI I PAGESAVE

Neni 52

Zbatimi i së drejtës kombëtare për procedurat e përfundimit të aktivitetit

1. Për sa i përket prishje, likuidimit, falimentimit dhe procedurave të ngjashme, një SE u nënshtrohet dispozitave ligjore që zbatohen për shoqëritë aksionare, të krijuara sipas ligjit shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Pa paragjykuar dispozitat e ligjit kombëtar, që kërkojnë publikime shtesë, nisja dhe përfundimi i procedurave për prishje, likuidim, falimentim, si dhe çdo vendim për vazhdimin e veprimtarisë publikohen në përputhje me nenin 2 të këtij ligji.

Neni 53

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë procedurat e hollësishme për deklarimin, trajtimin dhe shkëmbimin e të dhënave të detyrueshme sipas legjislacionit tatimor, legjislacionit për sigurimet shoqërore e shëndetësore, legjislacionit të punës dhe atij të statistikave, si dhe të miratojë procedurën e lëshimit të numrit unik të identifikimit të një SE-je.

2. Ministri, me propozimin e titullarit të QKB-së, përcakton formën dhe përmbajtjen e dokumenteve që lëshohen nga QKB-ja dhe formatet e kthimit të përgjigjes për çdo veprim të kryer sipas këtij ligji.



3. Ngarkohet ministri të miratojë procedurat e hollësishme për hedhjen dhe formën e hedhjes si dhe shfaqjen në regjistrë të një SE-je.

Neni 54

Shfuqizime në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian të gjitha dispozitat e këtij ligji shfuqizohen.

Neni 55

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekreten nr. 465, datë 3.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 465, datë 3.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 78/2026, “Për statutin e shoqërisë evropiane (SE)”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 85/2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 10 018, DATË 13.11.2008,
“PËR AVOKATURËN E SHTETIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

Faqe | 17600

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 3 fjalët “ose zyrat e Avokaturës së Shtetit” hiqen.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Avokatura e Shtetit ka në përbërjen e saj ndihmësit ligjorë të avokatëve të shtetit dhe administratën mbështetëse. Marrëdhëniet juridike të punës së ndihmësve ligjorë të avokatëve të shtetit rregullohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe të Kodit të Punës. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të administratës mbështetëse rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës.”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “c”, e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“c) përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të organeve të vetëqeverisjes vendore përpara gjykatave të të gjitha niveleve, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat këto organe janë palë. Në çështje të veçanta, sipas kriterëve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miraturar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t’ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të vetëqeverisjes vendore;”.

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në shkronjën “b” fjalët “për ato raste kur asistencë juridike ofrohet në përputhje me shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni” hiqen;

b) në shkronjën “c” fjalët “pavarësisht nga marrëveshja e lidhur, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni” hiqen.



Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Pranë misionit të përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit cakton një ose disa avokatë shteti si përfaqësues të përhershëm dhe që veprojnë në emër të tij pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”.

2. Në pikën 5, fjalët “nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit” hiqen.

Neni 4

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 12 ndryshohet dhe zëvendësohet me “Avokatët e shtetit pranë ministrive”.

2. Në pikën 1, fjalët “krijohen zyra me” zëvendësohen me fjalët “veprojnë”.

3. Në pikën 3, fjalët “ose zyrat e Avokaturës së Shtetit” hiqen.

Neni 5

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Ndihmësi ligjor i avokatëve të shtetit

1. Ndihmësi ligjor i avokatëve të shtetit emërohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në nivel qendror dhe vendor, në bazë të parimit të shanseve të barabarta, meritës e profesionalizmit, nëpërmjet procedurave përzgjedhëse, sipas strukturës dhe organikës së Avokaturës së Shtetit, të miratuar me urdhër të Kryeministrit.

2. Ndihmës ligjor i avokatit të shtetit emërohet personi që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” brenda vendit ose diplomë të njësuar me të apo të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

c) të ketë jo më pak se 1 (një) vit përvojë pune në fushën juridike;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga shërbimi civil apo çdo funksion tjetër publik për shkelje ose paaftësi në kryerjen e detyrave;

dh) të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit cakton ndihmësin ligjor të avokatit të shtetit pranë një ose disa avokatëve të shtetit.

4. Ndihmësi ligjor i avokatit të shtetit analizon praktikën gjyqësore përkatëse për interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim, përpunon çështjen dhe përgatit mbrojtje të thjeshta standarde me shkallë kompleksiteti të ulët për përfaqësimin dhe mbrojtjen nga avokati i shtetit, kryen detyra të tjera për hetimin administrativ dhe përpunimin e çështjes, siç kërkohet nga avokati i shtetit. Rregullat specifike, të drejtat dhe detyrat e ndihmësit ligjor të avokatit të shtetit përcaktohen me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

5. Rregulla më të hollësishme për procedurën përzgjedhëse, marrëdhënien e punës, vlerësimin e rezultateve në punë, formimin vazhdues, disiplinën, lirin dhe shkarkimin nga detyra të ndihmësit ligjor të avokatëve të shtetit, si dhe elementet e tjera që lidhen me ushtrimin e këtij funksioni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Në nenin 20 bëhen këto shtesa:

1. Në shkronjën “c”, të pikës 1 pas emërimit “Shkollës së Magjistraturës” shtohet teksti me këtë përmbajtje:

“ose plotëson një nga kriteret e mëposhtme:

i. zotëron përvojë pune mbi 7 vjet si ndihmës ligjor i avokatit të shtetit në Avokaturën e Shtetit;

ii. zotëron përvojë pune mbi 10 vjet si avokat, profesor, lektor i së drejtës ose ka ushtruar mbi 10 vjet profesionin e juristit në një nga institucionet qendrore të administratës publike.”.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Emërimi i avokatëve të shtetit, sipas nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni nuk mund të jetë më shumë se 50% e vendeve vakante të përvitshme, numri total i të cilave përcaktohet çdo datë 31 të muajit janar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.



1/2. Përfashtimisht, nëse gjatë të njëjtit vit kalendarik nuk plotësohen vendet vakante të mbetura, nëpërmjet provimit të pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës këto vende vakante plotësohen, sipas përcaktimeve të nënndarjeve “i” dhe “ii”, të shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni, nëpërmjet procedurës përzgjedhëse, sipas rregullave të hollësishme të miratuara me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, bazuar në parimet e shanseve të barabarta, meritës dhe profesionalizmit.”.

Neni 7

Pas pikës 4, të nenit 27 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Paga e ndihmësit ligjor të avokatit të shtetit është sa 0,45% e pagës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.”.

Neni 8

Pas kreut VIII shtohet kreu VIII/1 me këtë përmbajtje:

“KREU VIII/1 KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 33/1

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga titullari dhe/ose nga nëpunësi përgjegjës i personit juridik që është palë në një proces gjyqësor, të cilit i ofrohet shërbimi i përfaqësimit nga Avokatura e Shtetit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

a) mosparaqitja e dokumentacionit, shpjegimeve, informacioneve apo qëndrimit të institucionit, të nevojshme për shqyrtimin e çështjes së Avokaturës së Shtetit, brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës pranë këtyre institucioneve, kur ky informacion është i domosdoshëm për ushtrimin e funksionit të përfaqësimit apo të mbrojtjes ligjore, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) mosdepozitimi ose depozitimi i pasaktë i informacionit dhe akteve procedurale pranë gjykatës gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

c) mosparaqitja apo refuzimi i pajustificuar për të marrë pjesë në procesin gjyqësor për të dhënë shpjegime, për të nënshkruar ose për të miratuar qëndrimin institucional, kur kërkohet nga Avokatura e Shtetit, ose kryerja me dashje e veprimeve apo mosveprimeve që pengojnë seriozisht përfaqësimin dhe mbrojtjen ligjore të interesave pasurore shtetërore, nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Në çdo rast, kur kanë ardhur pasoja për interesat pasurore të shtetit, titullari dhe nëpunësi përgjegjës përgjigjet sipas legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë civile. Në këto raste personi juridik ka të drejtë të ngrejë padi regresi në gjykatë.

3. Me nëpunës përgjegjës kuptohet drejtuesi i strukturës që mbulon përfaqësimin në gjykatë apo punonjësi me profil jurist, të ngarkuar me përfaqësimin në gjykatë të institucionit dhe shkëmbimin e informacionit me Avokaturën e Shtetit.

4. Gjobat vendosen nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe arkëtohen në buxhetin e shtetit.

5. Procedura për vendosjen e gjobës dhe formati tip përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33/2

Shlyerja e masës së dënimit me gjobë

Shlyerja e masës së dënimit me gjobë bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për kundërvajtjet administrative.

Neni 33/3

Ankimi i sanksioneve administrative

Personi ndaj të cilit është vendosur masë administrative, sipas dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.”.

Neni 9

Neni 35 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 36 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “të nenit 4, pika 7” shtohen fjalët “të nenit 12/1, pika 5” dhe pas



fjalëve “dhe nenit 28” shtohen fjalët “dhe nenit 33/1, pika 5”.

2. Në pikën 3, para fjalëve “të nenit 30, pika 4, shkronja “c”” shtohen fjalët “të nenit 12/1, pika 4, të nenit 20, pika 1/2, dhe”.

Neni 11
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të nenit 12/1, pika 5, të ligjit për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën përzgjedhëse, marrëdhënien e punës, vlerësimin e rezultateve në punë, formimin vazhdues, disiplinën, lirimimin dhe shkarkimin nga detyra të ndihmësit ligjor të avokatëve të shtetit, si dhe elementet e tjera që lidhen me ushtrimin e këtij funksioni.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të nenit 33/1, pika 5, të ligjit për përcaktimin e procedurës për vendosjen e gjobës dhe formatit tip.

3. Ngarkohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin në zbatim të nenit 12/1, pika 4, të ligjit për përcaktimin e rregullave specifike, të drejtave dhe detyrave të ndihmësit ligjor të avokatit të shtetit.

4. Ngarkohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin në zbatim të nenit 20, pika 1/2, të ligjit për përcaktimin e rregullave të hollësishme të procedurës përzgjedhëse për plotësimin e vendeve vakante, sipas parashikimeve të kësaj dispozite.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2027.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 469, datë 4.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 469, datë 4.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 85/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, ‘Për Avokaturën e Shtetit’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 86/2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 10 093, DATË 9.3.2009,
“PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
PËR MBËSHTETJEN
E SHOQËRISË CIVILE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 4 e nenit 2 ndryshohet si më poshtë:
“4. Statuti i AMSHC-së miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të bordit mbikëqyrës, i cili vendimin e përcjell nëpërmjet ministrit përgjegjës për mirëqenien sociale.”.



Neni 2

Në pikën 4 të nenit 8 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Organizatat e shoqërisë civile, të regjistruara sipas ligjit, kanë të drejtë t’i dërgojnë propozimet për përfaqësim në bordin mbikëqyrës pranë ministrit përgjegjës për mirëqenien sociale, i cili ia propozon ato Këshillit të Ministrave”.

2. Pas fjalisë së dytë shtohet fjalja me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e bordit mbikëqyrës, përfaqësues të institucioneve të administratës publike qendrore, propozohen në Këshillin e Ministrave nga ministri përgjegjës për mirëqenien sociale.”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “P” shfuqizohet.

2. Në shkronjën “g” pas fjalëve “ për veprimtarinë e AMSHC-së” shtohen fjalët “nëpërmjet ministrit përgjegjës për mirëqenien sociale”.

3. Pas shkronjës “gj” shtohet shkronja “ h” me këtë përmbajtje:

“h) miraton dhënien e grantit.”.

Neni 4

Në pikën 2, të nenit 10 hiqen fjalët “ e 12, pika 4”.

Neni 5

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“b) administron, mbikëqyr e drejton veprimtarinë e AMSHC-së, si dhe administron personelin në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin e agjencisë dhe vendimet e bordit mbikëqyrës, me përjashtim të kompetencave për punësimin e nëpunësve civilë, të cilat ushtrohen nga autoritetet përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil;”.

2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.

2. Në pikën 4 hiqen fjalët “ ose i drejtorit ekzekutiv”.

Neni 7

Pika 3 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

“3. Nivelet e pagave dhe të shpërblimit të punonjësve të AMSHC-së, si dhe të kryetarit e anëtarëve të bordit mbikëqyrës miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AMSHC-së rregullohen sipas parashikimeve të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës për punonjësit administrativë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.”.

Neni 8

Pas paragrafit të parë, të nenit 26 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Vendimi i bordit mbikëqyrës për miratimin e dhënies së grantit ankimohet në përputhje me parashikimet e neneve 130 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative.”.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 468, datë 3.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 468, datë 3.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,



DEKRETOJ:

Neni 2

Shpalljen e ligjit nr. 86/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 093, datë 9.3.2009, Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 88/2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9947, DATË 7.7.2008,
“PËR PRONËSINË INDUSTRIALE”,
I NDRYSHUAR²**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 111/dh, paragrafi ekzistues numërohet si pikë 1 dhe pas tij shtohet pika 2, si më poshtë:

“2. Masat, procedurat dhe mjetet juridike të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duhet:

- a) të jenë të drejta dhe të arsyeshme;
- b) të mos jenë në mënyrë të panevojshme të ndërlikuara ose të kushtueshme, si dhe të mos përfshijnë afate të paarsyeshme kohore ose vonesa të pajustificuara; dhe
- c) të jenë të efektshme dhe me efekt parandalues.”.

² Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën (BE) 2016/943, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 8 qershor 2016, “Mbi mbrojtjen e njohurive të fshehta dhe informacionit të biznesit (sekreteve tregtare) kundër

Në nenin 111/e shtohet pika 6, si më poshtë:

“6. Masat, procedurat dhe mjetet juridike të parashikuara në këtë nen zbatohen në një mënyrë, që:

- a) është proporcionale;
- b) shmang krijimin e pengesave për të legjitimuar tregtinë në tregun e brendshëm; dhe
- c) parashikon masa mbrojtëse kundër abuzimit të tyre.”.

Neni 3

Në nenin 111/g bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Gjykata, me kërkesën e mbajtësit të sekretit tregtar, urdhëron vendosjen e masave të përkohshme, me qëllim përfundimin ose ndërprerjen e veprimeve të përvetësimit, përdorimit ose bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, duke përfshirë ndër të tjera:

- a) ndërprerjen ose, sipas rastit, ndalimin e përdorimit, ose bërjes publike të sekretit tregtar në mënyrë të përkohshme;

- b) ndalimin e prodhimit, ofrimit, hedhjes në treg ose përdorimit të mallrave cenuese, si dhe ndalimin e importimit, eksportimit apo ruajtjes së mallrave cenuese për këto qëllime;

- c) konfiskimin ose vënien nën kontroll të mallrave të dyshuara si cenuese deri në përfundim të procesit gjyqësor, duke përfshirë mallrat e importuar, në mënyrë që të ndalohej hyrja ose qarkullimi i tyre në treg.

- ç) ndalimin e ofrimit ose sigurimit të shërbimeve që përdorin sekretin tregtar;

- d) ruajtjen e provave të rëndësishme për shkeljen e pretenduar, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial;

- dh) konfiskimin ose vënien nën kontroll të mjeteve të përdorura për prodhimin e mallrave të dyshuara si cenuese deri në përfundim të procesit gjyqësor;

- e) urdhëron në rastin e një shkeljeje të kryer në shkallë tregtare dhe nëse pala e dëmtuar demonstroi

përvetësimit, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm”. Numri CELEX 32016L0943, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 15.6.2016, faqe 1–18.



rrethana të tilla, që mund të rrezikojnë riparimin e dëmeve, bllokimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të pretenduar, përfshirë edhe bllokimin e llogarive të tij bankare dhe të aseteve të tjera. Për këtë qëllim, gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, ose shfrytëzimin e mundësive të tjera, të përshtatshme, për të zotëruar informacionin përkatës.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, si më poshtë:

“5. Gjkata, si alternativë ndaj masave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, mund të kushtëzojë vazhdimin e përdorimit të sekretit tregtar që pretendohet si i paligjshëm me vendosjen e garancisë, me qëllim sigurimin e kompensimit të mbajtësit të sekretit tregtar. Bërja publike e sekretit tregtar në këmbim të vendosjes së garancisë nuk lejohet.”.

Neni 4

Në nenin 111/h bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Procedurat në rast shkeljeje dhe masat korigjuese”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Mbajtësi i sekretit tregtar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kundrejt çdo personi që shkel të drejtat e tij për të kërkuar:

a) ndërprerjen e shkeljes ose, sipas rastit, ndalimin e përdorimit, ose bërjes publike të sekretit tregtar;

b) ndalimin e prodhimit, ofrimit, hedhjes në treg ose përdorimit të mallrave cenuese, si dhe ndalimin e importimit, eksportimit apo ruajtjes së mallrave cenuese për këto qëllime;

c) miratimin e masave korigjuese në lidhje me mallrat cenuese;

ç) shkatërrimin tërësisht ose pjesërisht të çdo dokumenti, objekti, materiali, substance ose dosjeje elektronike që përmban ose përfshin sekretin tregtar ose, kur është e përshtatshme, vendosjen e të gjithë, ose një pjesë të këtyre dokumenteve, objekteve, materialeve, substancave ose dosjeve elektronike nën kontrollin e paditësit;

d) ndalimin e veprimeve të paautorizuara që shkaktojnë një rrezik serioz për përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar;

dh) heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil të mallrave cenuese, materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin e mallrave cenuese apo ofrimin e shërbimeve në mënyrë të paligjshme;

e) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata;

ë) shpërblimin e çdo dëmi të shkaktuar nga përvetësimi, përdorimi ose bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar.”.

3. Në pikën 2, paragrafi i dytë shfuqizohet.

4. Pas pikës 2 shtohet pika 3, si më poshtë:

“3. Çdo masë e marrë nga gjykata dhe veçanërisht masat e parashikuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1 të këtij neni, do të kryhen me shpenzimet e shkelësit, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të veçanta për të mos vepruar në këtë mënyrë. Këto masa zbatohen pa cenuar çdo dëmshpërblim që mund t'i detyrohet mbajtësit të sekretit tregtar për shkak të përvetësimit, përdorimit ose zbulimit të paligjshëm të sekretit tregtar.”.

5. Pas pikës 3 shtohet pika 4 si më poshtë:

“4. Masat korigjuese të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 1 të këtij neni përfshijnë:

a) tërheqjen e mallrave cenuese nga tregu;

b) heqjen e elementeve që përbëjnë shkelje tek mallrat cenuese;

c) shkatërrimin e mallrave cenuese ose, sipas rastit, largimin e tyre nga tregu, me kusht që ky largim të mos dëmtojë mbrojtjen e sekretit tregtar.”.

Neni 5

Në nenin 111/i pas pikës 3 shtohet pika 4, si më poshtë:

“4. Me kërkesën e personit që mund t'u nënshtrohet masave të përcaktuara në nenin 111/h të këtij ligji, gjykata mund të vendosë pagimin e një kompensimi financiar në favor të palës së dëmtuar, në vend të zbatimit të këtyre masave, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) personi në fjalë, në kohën e përdorimit ose bërjes publike, nuk ishte në dijeni dhe as nuk mund të ishte në dijeni, sipas rrethanave, të faktit se sekreti tregtar ishte përfutur nga një tjetër person që ishte duke e përdorur ose e kishte bërë publike në mënyrë të paligjshme;



b) ekzekutimi i masave përkatëse do t'i shkaktonte këtij personi një dëm joproporcional; dhe

c) kompensimi financiar në favor të palës së dëmtuar paraqitet si mjaftueshëm i arsyeshëm.

Kur vendoset kompensimi financiar në vend të masave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 111/h të këtij ligji, ky kompensim nuk duhet të tejkalojë shumën e tarifave që do të ishin të pagueshme nëse personi në fjalë do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e sekretit tregtar në fjalë, për periudhën kohore gjatë së cilës përdorimi i sekretit tregtar mund të ishte ndaluar.”.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 471, datë 4.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 471, datë 4.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 88/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, ‘Për pronësinë industriale’”, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 441, datë 30.7.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të

ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Erind Mentor Sykja
2. Sira Erind Sykja
3. Blerina Skënder Pano
4. Dea Edi Pano
5. Klea Edi Pano

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 442, datë 30.7.2026

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Marjola Selam Bezati
2. Foti Rigels Bezati
3. Iri Vasil Koçi
4. Brandon Granit Taullai
5. Klest Granit Taullai



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 443, datë 30.7.2026

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Deborah Ilir Beqaj
2. Klea Nexhbedin Avdiu
3. Ariena Aleksandër Lala

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 444, datë 30.7.2026

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sabina Dhimitraq Stratobërdha
2. Klaudia Agim Prodani
3. Xhevrije Myftar Kuca
4. Marsela Shkëlqim Matoshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 445, datë 30.7.2026

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ardit Begtash Avdyli
2. Jola Dhimitraq Danaj
3. Vilma Shemsi Markja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 446, datë 30.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8/a, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Rudy Ghassan Awad

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 447, datë 30.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8/a, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Anabelle Tango Ferdinand Retutal Alcantara

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 448, datë 30.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8/a, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Aydin Hasan Huseyin Erturk

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 449, datë 30.7.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8/a, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Blendi Agron Pustina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 450, datë 30.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8/a, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Minire Rasim Çulaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 451, datë 30.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Sadik Tefik Maqedonci

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 452, datë 30.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Bujar Remzi Rustemi



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 453, datë 30.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Kaan Ragip Kadriaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 454, datë 30.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Blerim Ali Morina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 455, datë 30.7.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Dardane Feriz Berisha Morina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 464, datë 3.8.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Albion Driton Rrahmani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 14, datë 3.8.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 27, DATË 29.12.2017, TË MINISTRI
TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË,
“PËR STRUKTURAT E BRENDSHME
AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Pika 17, e udhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për strukturat e brendshme akademike dhe

administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, ndryshon si më poshtë:

“17. Strukturat e auditimit të brendshëm janë në varësi të Rektorit të institucionit publik të arsimit të lartë.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 766, datë 27.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E
SERBISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Serbisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja Administrative e Nivelit 1	Ndarja Administrative e Nivelit 2*
1.	Raški	Raška*

Shënime: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.



4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

NJOFTIM
Nr. 1953/4, datë 3.8.2026

**PËR HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes”, nënshkruar në Romë, më 13.11.2025, ka hyrë në fuqi në datën 24 korrik 2026.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 173][Datë: 06.08.2026 12:31:03
+02:00][dfb1bea8-3de6-49c8-bcf0-039451f7c7f5]

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)